

## 1. Blegtoria biologjike

Mishi dhe qumështijanë produkte bazë për ushqimin e njeriut. Kërkesat për cilësi për këto dy produkte rriten çdo ditë. Kalimi i fermave blegtorale në ferma bio po ecën me shpejtë në vendët e zhvilluara të botës. Prodhimimi i mishit, qumështit dhe nënprodukteve të tyre kanë një rrugë të gjatë që duhet respektuar mirë deri sa produkti të vijë në tavolinën e konsumatorit. Një nënprodukt tjetër i blegtorisë është edhe leshi bionga prodhohen veshje leshi biologjike. Produktet e leshit që vijnë nga blegtoria biologjike, ashtu si produktet e pambukut biologjik, kanë përparsi për tu përdorur nga fëmijët dhe grupet e tjera delikate të shoqërisë.

Standardi i blegtorisë biologjike është shumë i gjrë dhe i hollësisëm. Por në këtë pjesë do të përmendim vetëm parimet kryesore, ndaj të cilave standardi nuk e toleron

Ndër rregullat kryesore të standartit që duhet zbatuar janë:

-Kafshët duhet të vijnë nga prindër të rritur me standartin biologjik

-Kafshët duhet të ushqehen nga shqime që vijnë nga parcelat e çertifikuara bio. Bari i feskët i livadheve, bari thatë, jonxha, koncentratet me bimë bishtajore ose drithëra, duhet të vijnë nga parcelat e çertifikuara si parcela me prodhim biologjik.

Kafshët nuk lejohet të ushqehen me produkte me origjinë nga bimët me modifikime gjenetike. Kujdes bëhet për të kontrolluar sojaën dhe misrin, dy bimë që kanë sipërfaqen më të madhe në botë si bimë me modifikime gjenetike.

-Ilaçet e kafshëve duhet të jenë nga lista e ilaçeve të lejuara nga standarti përkatës.

-Nuk lejohet përdorimi i hormoneve për nxitjen e rritjes së peshës së kafshëve

-Nuk lejohen ose lejohen me kushte përdorimi i antibiotikeve.

-Duhet respektuar standarti i jetësës së kafshëve në stalla. Me këtë kuptojmë hapësirën e çdo kafshe në stallë, kafshët nuk duhen lidhur, bokset e viçave duhet të jenë të veçanta dhe kafshët duhet të jenë të lira dhe jo të lidhura me litar.

-Stalla duhet të ketë dritë normale, e llogoritur që kafshët të mos ndiejnë stres nga mungesa e dritës.

-Duhet respektuar standarti i kohës që duhet të qëndrojnë kafshët në fushë dhe në stallë.

Kur kafshët qëndrojnë një sasi kohe në natyrë, kjo ndikon në shëndetin e tyre, për pasojë kjo pasqyrohet në cilësinë e produkteve që kafshët prodhojnë.

-Duhet respektuar rregullat e therjeve në therotore. Edhe në thertore ka ca rregulla e rigorozë, të cilat shmangin stresin e kafshëve para therjes. Kafshët nuk duhet të shikojnë as thikat e therjes.

-Transporti i kafshëve nga një vend në tjetrin duhet të bëhen me mjete të rehapëshme , dhe në këto mjete gjithonë mbahet parasysh hapsira e nevojshme në mjetin e transportit, në përputhje më numrin e kafshëve. Kafshët gjatë kohës së transportit u sigurohen ushqime dhe ujë i pijëshëm.

-Gjithashtu magazinimi i mishit, frigorifrët, paketimi ,përpunimi i mishit bio, ka rregulla të shkruara në standart.

-Nuk lejohet që viçave tu jepët qumësht artificila, por qumësht vetëm nga kafshët mëma.

Edhe për qumështin janë këto rregulla plus dhet specifike që ka higjena e qumështit të realizohet plotësisht, me ngarkesë bakteriale në kufijtë e standartit.

Kërkesat për qumësht biologjik kanë pësuar një bum,ndosnse shitet me çmim dyfish.

-Disa klientë i drejtohen qumështit bio për arsye shëndeti, disa për sensibilitet ndaj mjediist, disa mendojnë se bujqësia bio mbron më mirë të drejtat e kafshëve.

Standarti I qumështit bio në SHBA thekson këto pika me rëndësi:

#### Hormonet

-Kafshët nuk duhet të jenë të trajtuara me hormone( Bovine Groëth Horomone )(BGH) që përdoren për të rritur prodhimin e qumështit.Njerzit kanë frikë se këto hormone I lidhin me hormone që nxisin cancerin, ose këto hi pomone çojnë në rritjen e substancave të ngjashme me insulinën(Insuline Groëth Faktor-1) pra insulin factor për ritjen e kafshëve, substance që sipas perceptimit konsumatorëve nxisin cancerin.

Por edhe për rrezikun real të këtyre substancave ka diskutime pro dhe kundra, por perceptimi negative I konsumatorëve ndaj hormoneve është e vështirë që të zhduket

#### Antibiotikët

Antibiotikët janë një kriter I fortë në tofat e lopëve bio.Kur një lopë ka marë antibiotikë, ajo mund të kthehet në tufën e lopëve bio pas 12 muajve ose pas një testi në gjakun e saj që vërteton se antibiotiku është shkatërruar plotësisht.Para tregëtimit tanket ose enët me qumësht para tregtimit testohen nëse kanë antibiotikë.

#### Pesticidet

Të qenit të pastër nga mbetjet e pesticideve është një kërkesë e tretë dhe e fortë e standatit Amerikan për qumështin biologjik.Kufijtë e mbetjeve mund të lejohen në kufij fare minimal

#### Kullotja në fushë

Eshtë edhe kjo një kërkesë që kafshët një pjesë të kohës të kullosin jasht në natyrë, por ka mendime se kjo nuk duhet të jetë strict.Por të dalurit në një oborr të madh që kafshët të qëndrojnë disa orë në ajrin e pastër dhe në diell është e preferueshme se si nga na shkencore

që kafshët largojnë stresin dhe nga ana psikologjike e konsumatoreëve kjo pral ktikë rritje është e preferueshme. Disa sjelin argument raporti bari njomë-koncentrat mund të shtoi në qumësht nivemin e acidit lineolik konjugatin (CLA) një tipspecial yndyre që mund të mbrojë organizmin e njerzëve nga shkaktarët e kancerit dhe ndaj problemve të tjera shëndetsore. Profesor Michael Pariza nga Universiteti Ęisconsin thotë se kur kafshët konsumojnë si barë të njomë ashtu edhe koncentrat kanë më shumë në qumështin e tyre sumstanca të CLA. Megjithatë prodesori rekomandon më mirë kufizoni mish e qumësht dhe shtoni frutat e perimet që ti merni këto substance shëndet mbrojtëse.

## **2.Pularia biologjike**

Pularia biologjike zbaton pak a shumë standartin e kafshëve biologjike, megjithëse ka disa specifika.

## **3.Bletaria biologjike**

Shumë pika të standartit të blegtorisë biologjike zbatohen edhe te bletaria biologjike

Vështirësia e bletarisë biologjike, është fakti që bletët për prodhimin e mjaltin kullosin në distanca disa kilometra larg vendit të banimit të tyre. Kjo kërkon kujdes që bletët të mos kullosin në lulet, bimët e të cilave janë spërkatur me produkte të mbrojtjes së bimëve konvencionale. Bashkë me polenin ato marin edhe mbetjet e PMB-ve (insekticide dhe fungicide)

Mjalti bio është ndër produktet që konsumatori e preferon ndoshta më shumë se produktet e tjera. Dukë ardhur gjithmonë nga natyra, duke u përdorur më shumë për shëndet se sa për ushqim, ose më mirë me thënë më shumë si ilaç sesa si ushqim, ka bërë që konsumatorët të pyesin me gjatë për origjinën e mjaltit se sa të një ushqimi tjetër.

Disa nga kriteret bazë të standartit të prodhimit të mjaltit bio janë:

-Zona kullosore e bletëve nuk duhet të jetë nën trajtimin me inpute konvencionali si pesticide dhe plehra kimike konvencionale.

-Për të siguruar këtë kusht kërkohet që parcela më e afërt që trajtohet me inpute konvencionale të jetë mbi tre km. largësi . që mundet të shmanget arritja nga bletët gjatë kërkimit për ushqim.

-Shtëpizat e bletëve duhet të jenë prej druri ose prej metali, por jo prej plastike.

-Dylli duhet të jetë nga dylli biologjik

-Nuk lejohet prerja e krahëve të mbretëreshës

Standarti I mjaltit bio ka specifikat e veta që lidhet me lëvizjen e bletëve në distance të mëdha nga vendi ku bletët banojnë dhe prodhojnë mjaltin, pra nga “lagjia ku banojnë”

Po përmendim disa Pikat kryesore të standartit për prodhimin, paketimin dhe tregtimin e mjaltit biologjik

-parku i p bletëve duhet të jetë vendosur në një rajon që menaxhohet me kriteret e bujqësis biologjike

-Poleni duhet të vijë nga rajonet që menaxhohen sipas parime biologjike, dhe në ato zona ku veprimataria e njeriut mundësisht mungon plotësisht

-parku bletëve duhet të jetë të paktën tre kilometra nga parcelat me bimë konvencionale, sepse është rreziku i trajtimeve produkte të mbrojtjes së bimëve.

-Zgjojt e bletëve duhet të jenë ndërtuar nga druri ose metali

-Druri i shtëpizave të bletëve duhet të vijë nga dru natyral dhe të mos jetë i trajtuar me kimikate

-Kur shtëpiza e bletës është prej palstike duhet të mvishet me dyll bio

-Periudha kalimtare nga dylli konvencional tek dylli bio duhet të realizohet gjatë periudhës kalimtare që në rastin e mjaltit bio është 12 mujore

-Ushqimi jo organik për bletët si rregull nuk lejohet, kjo mund të ndodhë në raste urgjente, ku nuk ka zgjidhje tjetër.

-Zëvendësimi mbretëreshës mund të bëhet kur lind nevoja

-Prerja e krahëve të mbretëreshës nuk lejohet


-Mbrojtja nga sëmundjeve duhet bazuar tek masat parandaluese

-Gjatë përpunimit të mjaltit ai duhet ngrohur mbi 35 °C

#### **4. Marketingu i produkteve biologjike**

Marketingu i produkteve biologjike, në shumë elementë është si për të gjitha produktet e tjera, por ka edhe specifikat e veta. Marketing është pjesa më e vështirë në ciklin e prodhimit nga mbjellja deri të konsumatori. Marketingu në bujqësinë biologjike përfshinë veprimatritë, të cilat lidhin produktin me konsumatorin.

Nga fusha te dyqani shitjes është një një lum i gjërë në mes. Për të ardhur produktet deri te konsumatori duhet ndërtuar ura. Tre janë elementët kryesorë të kësaj ure; Prodhimi, Çertifikimi dhe Marketing. Në tabelën e mëposhte



Nga fusha në tregun Bio, janë tre segmente që të kapërcehet ura:

Prodhimi, Certifikimi, Marketingu.

*Logo kombwtare shqiptare dhe logo e BE-sw*

